

VENDIM
Nr. 128, datë 10.2.2026

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “GRANTE PËR STARTUP-et DHE LEHTËSUESIT E STARTUP-eve PËR VITIN 2026”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare
- z. Besnik Çina anëtar;
- znj. Keida Qirko anëtare;
- z. Ahmet Maqcellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës, të datës 10.2.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” morri në shqyrtim njoftimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të planit të ndihmës shtetërore për thirrjen për grante dhe masa mbështetëse për startup-e dhe lehtësuesit e tyre.

I. Procedura

1. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, me shkresën nr. 21, datë 27.1.2026, “Mbi njoftimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore”, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të VKM-së nr. 844, datë 30.12.2025, “Për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si edhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve”.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i ndihmës synon zhvillimin e startup-eve dhe lehtësuesve shqiptarë në funksion të zhvillimit të vendit dhe përparimit në fushat prioritare.

- Baza ligjore: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, ligjin nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, i ndryshuar, si edhe VKM-në nr. 844, datë 30.12.2025, “Për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve”.

3. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2026.

4. Dhënësi i ndihmës është ministri përgjegjës për inovacionin, ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.

5. Përfituesit: Përfitues të skemës janë ndërmarrjet startup dhe lehtësuesit e startup-eve të vetëdeklaruar në regjistër që rezultojnë fitues pas procesit konkurrues të përzgjedhjes.

6. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. Forma dhe vlera e ndihmës: Për vitin 2026, bazuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, në programin 01150, llogaria ekonomike 604 është miratuar ndihma shtetërore në formën e grantit 300.000.000 (treqind milionë) lekë. Numri i përfituesve të skemës do të jetë 51–100 përfitues.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

8. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafit 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën

shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

9. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

10. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

11. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

12. Plan i ndihmës mundëson mbështetjen me burime shtetërore, për një numër të kufizuar të ndërmarrjeve në treg, të cilat do të duhej t’i përballonin me burimet e veta financiare në kushte normale të tregut. Plan i ndihmës përcakton disa kosto të pranueshme ose të shpenzimeve të përfituesit të ndihmës shtetërore që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e subjekteve startup dhe lehtësuesve, duke i dhënë një avantazh këtyre ndërmarrjeve, gjë që mund të shtrembërojnë ose kërcënojnë të shtrembërojnë konkurrencën. Ndihma do të akordohet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh duke përmbushur kushtin e selektivitetit.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

13. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me shkronjën “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ku parashikohet se ndihma shtetërore mund të lejohet nëse “lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”. Komisioni vlerëson se efektet ekonomike pozitive, potenciale të planit që lidhen me lehtësimin e zhvillimit të veprimtarive të caktuara ekonomike, tejkalojnë efektet negative potenciale në termat e shtrembërimit ose kërcënimit të shtrembërimit të konkurrencës. Plan i ndihmës do të stimulojë sipërmarrjen inovative dhe ndërmarrjet mbështetëse, duke i ofruar financim dhe mbështetje për ndërmarrjet startup dhe lehtësuesit më premtues shqiptar.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, që përcakton se ndihma shtetërore mund të lejohet nëse “lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 20, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për mbështetjen e startup-ve dhe lehtësuesit e startup-eve, të parashikuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.
2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruaj Deklaratën e Ndhmës “*De-minimis*” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.
3. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.
4. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.
5. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Maçellari